

UDHËZUESI I RIPARIMIT

pakësimi i mbeturinave – riparim në vend të hedhjes poshtë!

Këpucët e bukura prej lëkure janë prishur apo kolltuku i mirë ka nevojë për një rifreskim? Atëherë shikoni tek www.reparaturfuehrer.ch. Aty ofrojnë artizanët, artistët dhe institucionet shërbimet e tyre për riparim.

APLIKACIONI KVA



Aplikacioni KVA Thurgau ju informon rreth datave të rëndësishme të heqjes dhe deponimit në bashkinë tuaj. Me anë të mesazheve ju nuk do të harroni më kurrë vënien në dispozicion të mbeturinave dhe jeni gjithmonë të informuar mbi të rejat. I disponueshëm në App Store për iOS dhe Android.

**KENI PYETJE RRETH DEPONIMIT
NË MËNYRËN E DUHUR?
MË SHUMË INFORMACIONE NËN
WWW.KVATG.CH
OSE 071 626 96 26**

VËNIA NË DISPOZICION

Vënia në dispozicion e plehrave për transportim

Deri në orën 7.00 të mëngjesit të ditës përkatëse për transportimin e mbeturinave në vendin e grumbullimit të mbeturinave.

Thasë me tarifë

Vendosni mbeturinat shtëpiake në thasët zyrtarë me tarifë të KVA Thurgau. Mallra të rënda dhe dengje për djegie të vulosen me marka për mallrat e rënda dhe të vendosen pranë vendit për grumbullimin e mbeturinave.

Kontejnerët e pallateve

Të deponohen vetëm thasë zyrtarë të tarifave dhe mbeturinave të KVA Thurgau

Kontejner nën dysheme (UFC)

Të hidhen vetëm thasë zyrtarë të tarifave dhe mbeturinave të KVA Thurgau. Hedhja në çdo kohë e mundur. Ndalohet deponimi dhe hedhja e mallrave të rënda. Mallrat e rënda të KVA ose RAZ. Informacion rreth vendeve të grumbullimit të mallrave të mëdha dhe shërbimeve të mbledhjes së mbeturinave në nr. 071 626 96 26 ose www.kvatg.ch (www.kvatg.ch/dienstleistungen/dienstleistungen/ [kehrrechtsammeldienst/](http://www.kvatg.ch/kehrrechtsammeldienst/)).

Mallra të mëdha

Përgatitja e mallrave të mëdha dhe dengjeve (vetëm materiale që digjen) në pikat publike të grumbullimit.

Ngjisni në mënyrë të dukshme pullën për mallra të mëdha të KVA Thurgau:

- deri 5 kg 1 Markë
- deri 10 kg 2 Marka
- deri 20 kg 4 Marka
- deri 30 kg 6 Marka
- Masat maksimale: 100 × 70 × 50 cm
- Pesha maksimale: 30kg

Dengje dhe mallra të mëdha të veçanta mund t'i jepen grumbulluesve të mbeturinave në ditën e transportit.

Kontejnerë të rrezikshëm

Lëndë shpërthyes dhe djegëse si shishe kampingu me gaz dhe CO₂ NUK hidhen në mbeturina (Rrezik shpërthimi!).

Mbledhësit e mbeturinave nuk marrin me vete

- thasë të pambyllur dhe të tejmbushur
- mbeturina në kuti kartoni ose në qese për blerje
- materiale riciklimi (për ripërdorim)
- bojëra, lëngje, helme, kimikate dhe lëndë eksplozive
- mbeturina që mund të kompostohen (mbeturina jeshile nga kopshti/kuzhina)
- material që nuk mund të digjet

Shpenzime të veçanta

Për asgjësimin e mbeturinave që nuk janë vendosur në vendin e mbledhjes sipas rregullave, komuna i dërgon drejtpërsëdrejti shkaktarit një faturë për shpenzimet shtesë (të paktën Fr. 50.–).

TARIFAT E QESEVE TË MBETURINAVE

Tarifat zyrtare për qese të mbeturinave të KVA

Qese mbeturinash 17 litra, rrotull me 10 copë.	10.– Franga
Qese mbeturinash 35 litra, rrotull me 10 copë.	20.– Franga
Qese mbeturinash 60 litra, rrotull me 10 copë.	30.– Franga
*Qese mbeturinash 110 litra, rrotull me 5 copë.	25.– Franga

*të papërshtatshëm për kontejnerë gjysmë nën dysheme!









KUH-BAG

Qese mbeturinash 35 litra, rrotull me 10 copë.	14.– Franga
Qese mbeturinash 60 litra, rrotull me 10 copë.	20.– Franga

Bartës tarifar shtesë:

Pullë takse për mallra masive e KVA Thurgau, për copë	2.– Franga
Vulosje e plombuar (Plombim) për sipërmarrje, për copë	45.– Franga
Vinjetë vjetore 1× L për sipërmarrjet, për copë	2000.– Franga

SIMBOLET E PAKETIMIT

	Paketimet / materialet e riciklueshme	Te komuna ose te pika e shitjes
	Paketime që ripërdoren kryesisht me Depo	Te komuna ose te pika e shitjes
	Shishe pijesh PET	Të rikthehen në pikën e shitjes ose te RAZ/KVA
	Shishe plastike (bosh, që rimbyllen)	Të rikthehen në pikën e shitjes (Migros, Coop etj.) ose te RAZ/KVA
	Të përshtatshme për kompostim	Të kryhet kompostmi / fermentimi
	Mbeturina shtëpiake	E kanë vendin në qeset përkatëse të mbeturinave!
	Mbeturina të veçanta	Nuk e kanë vendin në qeset e mbeturinave!
	Substanca që ndotin ujin	Asnjëherë në tualet apo në lavaman!

DORËZIME TË DREJTPËRDREJTA PËR PERSONA PRIVATË

Oraret e hapjes

RAZ Weinfeld

Hapja e planifikuar,
tre-mujori i 2-te i 2018

Shoqata KVA

Thurgau, Weinfeld
071 626 96 26
Rüteliholzstrasse 5
info@kvatg.ch
Hënë–Premte 7.15–11.45/
13.15–17.00
*Enjte deri 18.30
*Shtunë 8.30–11.30

RAZ Frauenfeld

052 722 25 23
Juchstrasse 45
info@tricycling.ch
Hënë–Premte 7.00–11.45/
13.00–17.15
Enjte 7.00–11.45/
13.00–18.30
*Shtunë 7.30–12.30

RAZ Hefenhofen

071 411 57 27
Grundholzstrasse 9
raz.hefenhofen@kvatg.ch
Hënë–Premte 7.30–11.45/
13.30–16.45
*Shtunë 8.30–11.30

RAZ Kreuzlingen

Oborri i deponimit
071 688 81 22
Sonnenwiesenstr. 9a
raz.kreuzlingen@kvatg.ch
Hënë–Premte 7.30–11.30/
13.15–16.45
*Shtunë 8.30–11.30

Deponie Mühletobel Berg

071 636 15 76
Kehlhof
Të Hënë, Martë, Enjte, Premte
paradite
deponie.kehlhof@kvatg.ch
(Mërkurë dhe Shtunë mbyllur)
1.3. deri 30.10.: 7.00–11.45
1.11. deri 28.2.: 8.00–11.45

Në shoqatën KVA Thurgau dhe te RAZ mund të dorëzohen mbetjet si më poshtë:

Mbetje të djegshme: Fr. 205.20 për ton (përf.TVSH.)
Sasia minimale e faturuar për dorëzim: Fr. 10.–
(korrespondon me 40 kg)

Oraret e hapjes gjatë ditëve të festave:

www.kvatg.ch

*dorëzime vetëm për privatë



LETRA TË PËRDORURA



Në grumbullimin e letrave përfshihen: vini në dispozicion vetëm letra të pastra si gazeta, revista, letra të shtypura, libra dhe numërorë telefonikë pa kapakë etj.

Mos i vendosni në kuti prej kartoni, qese prej letre ose plastike.

Nuk përfshihen në grumbullimin e letrave: ambalazhet e qumështit dhe të pijeve të tjera, letër me shtresa prej materialeve të tjera, ngjitëse, qese, etiketa, sende plastike, kartona (shih nën 'Karton'), zarfe etj.



ALUMIN/TENEQE



Ambalazhe konservimi prej alumini, teneqeje, dhe kanoçe për ushqime kafshësh, tubeta etj.: Hiqni letrat, kanoçet i shpëlani me ujë të ftohtë. Ambalazhe me shtresa prej materialeve të tjera si dhe fleta plastike (folie) hidhen në mbeturinat shtëpiake.

Kapsula Nespresso

Në enën përkatëse grumbulluese të dërgohen në RAZ/KVA ose të rikthehen te shitësi.



BATERI



Bateritë e thata dhe në formë kopse, akumulatorë nga pajisje elektroshtëpiake dhe elektronike duhet të kthehen në vendin ku janë blerë ose të çohen në RAZ/KVA, eventualisht në vendin e grumbullimit të komunës.

Bateritë e automjeteve kthehen **pa pagesë** te shitësit ose çohen në RAZ/KVA.

Mos derdhni acidin e akumulatorëve në kanalizim ose në natyrë!



MBETURINA NDËRTIMORE / QERAMIKË



Majolikë, sende prej argjile, porcelan, enë rezistente ndaj zjarrit, xhama, pasqyra, tjegulla, gurë, beton. Sasi të vogla në RAZ/KVA, eventualisht në vendin e grumbullimit të komunës.

Vetëm në vend shkarkimin RAZ/ Deponie Mühlletobel:

Allçi, eternit, asbest, mbeturina ndërtimore me lëndë të dëmshme, izolime me fibra minerale dhe fibra qelqi.

Sasi të vogla: deri në 20kg, falas

Sasi të mëdha:

Këshillimi për mbeturinat 071 626 96 26



LLAMBA SHKARKUESE



Mos i thyeni llambat e neonit ose llambat me gazra të tjera, llambat kursyese, llambat me zhivë.

Kthehen falas (vRG) në pikën e shitjes ose në RAZ/KVA, eventualisht në vendin e grumbullimit të komunës.

Llambat normale në mbeturinat shtëpiake.



MBETURINAT ELEKTRIKE



Pajisje elektronike

Pajisjet shtëpiake, për argëtim, të zyrës, për komunikim si dhe CD të vjetra me të dhëna dhe muzikë, DVD dhe disqe Blue-Ray-Discs pa kasë mbrojtëse kthehen **falas (vRG)** në pikën e shitjes ose në RAZ/KVA.



QELQ



Shishet e pijeve dhe enët konservuese prej qelqi **ndahen** sipas ngjyrës (pa ngjyrë, ngjyrë kafe, ngjyrë jeshile). Hiqni materiale të tjera si pjesë metalike, qeramike dhe plastike!

Shishet dhe enët me peng kthehen te pikat e shitjes.

Mos hidhni këtu enë kuzhine, pjata etj. si dhe xhama të dritareve dhe pasqyave.



MBETURINA JESHILE



Mbeturinat jeshile nga kopshti dhe kuzhina, kompostoni vetë aty ku është e mundur.

Heqja e mbeturinave jeshile

Duke u bazuar në informacionet e Komunës (Informacion dhe grumbullimi i mbeturinave), shih faqen e përparme.

Kompostimi në kopshtin shtëpiak

Dokumentet, këshillimi dhe kurset trajnuese mbi kompostimin e KVA Thurgau, tel. 0791050943 ose kompostberatung@kvatg.ch.

Për njoftime kursi dhe këshilla

www.kvatg.ch/kompostinfos



MBETURINA SHTËPIAKE



Mbeturinat që mund të digjen dhe për të cilat nuk ka ripërdorim ose nuk është i nevojshëm asgjësimi i veçuar, u jepen mbledhësve të mbeturinave (kini parasysh simbolet e asgjësimit). Vënia në dispozicion në thasët me taksë të KVA Thurgau.

Në rast pasigurie kontakti shërbimin konsultativ të mbeturinave: 071 626 96 26

Datat për shtyrjen e mbledhjes së mbeturinave tek www.kvatg.ch > Aktuale ose me aplikacionin KVA-App.



KARTON



Në grumbullimin e kartonave përfshihen:

Ambalazhe të pastra prej kartoni, karton i valëzuar etj. (simboli i riciklimit). Shtypini kartonat. Lidhini, mos i përzini me letra, të mos ketë lëndë të tjera si shirita ngjitëse etj.!

Nuk bëjnë pjesë në këtë grumbullim:

Kartona që mbajnë simbolin për mbeturina shtëpiake, p.sh. kuti të pijeve ('Tetrapak') etj.



FRIGORIFERË / PAJISJE FTOHËSE



Pajisje ftohëse shtëpiake kthehen **pa pagesë** (vRG) te pikat e shitjes ose dorëzohen në RAZ/ KVA (vendet zyrtare të grumbullimit SENS).

Pajisje ftohëse nga ndërmarrjet:

Këshillimi për mbeturina 071 626 96 26 ose SENS 043 255 20 00



METALE



Hekura të vjetra, metale me ngjyra, tigane, biçikleta pa goma, pjesë të makinerive, mobilie prej metali etj. dorëzohen në grumbullimin e metaleve të komunës ose te RAZ/ KVA. Automjete të vjetra çohen te makineria e copëzimit.

Këtu nuk përfshihen pajisje ftohëse/ frigoriferë, soba, lavatriçe, mbeturina elektronike, bateri, pjesë plastike etj.



VAJRA



Mblidhni vajrat ushqimorë dhe ato mineralë (p.sh. vaj motori) veç e veç. Dërdhni në kazanët e caktuar për vajra. **Mos i përzieni!**

Përdorni vendet e grumbullimit të komunës. Mos i dërdhni në kanalizim ose në natyrë.



SHISHE PIJESH PET



Shisheet PET të pijeve **kthehen të pastruara te shitësit ose RAZ/ KVA** të pastruara te shitësit dhe hidhen në mbajtëset e posaçme të grumbullimit (shtypni shisheet).

Në Pikën grumbulluese PET duhen përjashtuar:

Shishe plastike për shampo, vaj, uthull, detergjentë si dhe shishe PET të papastra.



SHISHE PLASTIKE (PE)



Në këtë vend të grumbullimit vetëm shishe plastike boshe të tejdukshme të amvisërisë.

Nuk bëjnë pjesë në këtë grumbullim:

Shishe PET, shishe boshe të plastikës nga fusha e veprimtarisë shtëpiake, automobilistike, të kopshtarisë.



KUH-BAG



Mblidhen:

shishe boshe të plastikës nga fusha e veprimtarisë shtëpiake, si kova, gota, paketimet e ushqimeve, shisheet e shamos apo të ilaçit të rrobave, tetrapak, cantat e pazarit.

Nuk bëjnë pjesë në këtë grumbullim:

Lodra, tuba, zorra, paketime ushqimore të pista, teneqe, shishe nga përdorimi shtëpiak, për automjete dhe nga kopshtaria, shishe pije PET.

Pikat e shpërdarjes dhe kthimit:

RAZ/ KVA ose tek www.kuh-bag.ch



MBETURINA TË MËDHA, TË DJEGSHME



Dyshekë, mobilie, artikuj plastike, tapetë, etj.: Artikuj tekë dhe sasi të vogla u jepen grumbulluesve të mbeturinave, sendeve t'u vihet pulla sipas tarifës së mbeturinave në vend të dukshëm.

Masat maksimale/ pesha:

100 x 70 x 50 cm, 30 kg

Deri 5 kg 1 Markë, deri 10 kg 2 Marka,

deri 20 kg 4 Marka deri 30 kg 6 Marka

Sasi më të mëdha jepen në RAZ/ KVA kundrejt tarifës. Shërbimet e mblëdhjes dhe deponues privat shih www.kvatg.ch > shërbimi i mblëdhjes së plehrave > deponimi i mallrave të mëdha



«STIROPOR» / «SAGEX»



Mbeturina të papërziera polisteroli nga përdorimi shtëpiak (pa mbeturina të tjera!) mund të dorëzohen falas në RAZ/ KVA (eventualisht në pikat e grumbullimit të komunës.)



TEKSTILE



Tekstile Rroba, stofra, eventualisht edhe këpucë të mira, sipas porosisë së organizatës grumbulluese vendosen në thasët përkatës, eventualisht depozitohen në kontejnerët grumbullues të komunës.

U jepen mbledhësve të mbeturinave:
Tekstilet dhe këpucët e papërdorshme dhe të papastra.



KAFSHË TË NGORDHURA



Kafshë të vogla të ngordhura pa sende të tjera (shirita, thasë plastike etj.) çohen në vendin e grumbullimit të kufomave. Në asnjë mënyrë nuk groposen në pyll, nuk hidhen në ujëra dhe nuk u jepen mbledhësve të mbeturinave!

Informacione: 071 626 96 26



DRU



Dru i përpunuar si mobilie, dërrasa, paleta, dru i mbetjeve nga shembja etj, dru i lagur. Sasi të vogla druri mund të merren nga RAZ/KVA kundrejt tarifës. Në traversat hekurudhore duhet të hiqen pjesët metalike.

Copat nuk duhet të jenë më të mëdha se 4 m.



GOMA



Goma motorri, makine, traktori kthehen kundrejt tarifës në pikat e shitjes ose në RAZ/KVA.

Pranohen: deri në 100 kg goma të vjetra (edhe me pjesën metalike), goma teke biçiklete mund të deponohen në mbeturina.

Kosto: Sipas listës zyrtare për mbeturinat

Sasi të mëdha:
Këshillimi për mbeturinat 071 626 96 26

MBETURINA TË VEÇANTA /HELME



Kimikate, acide, alkale, llak, bojëra, hollues, medikamente, substanca mbrojtëse për dru dhe bimë, dezinfektues dhe detergjentë, mbeturina me zhivë (termometra). Shishe të kampingut, gazit dhe shishe CO₂.

Dorëzimi në vendet e grumbullimit të helmeve të RAZ/KVA (vetëm për privatë) ose në pikat e blerjes.

Sasi të vogla: deri 20kg, falas

